

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Gjyqtari MSc.Fatmir Baloku në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësës K-S “I” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari F. Z. nga Prishtina, kundër të paditurit P. K. nga Peja, për pagesën e borgjit , vlera e kontestit ... euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 24.01.2017. me dt.25.01.2017 bjen këtë:

## A K T G J Y K I M

DETYROHET i padituri P. K. që në emër të borgjit ti paguajë shumën prej ...euro , me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e vendosjes e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Paditësja me padinë e parashtruar në këtë gjykatë ka kërkuar që ti paguhet borgji shuma prej ... euro në emër të polisës mbi sigurmin shëndetësor. Më tej në padi theksohet se paditësi dhe i padituri janë pajtuar që për policën e kontraktuar , primin e sigurmit në shumë të terësishme prej ... euro, i padituri ta paguajë në ... këste mujore për çka përcaktuan edhe dinamikën e pagesës . Sipas kësaj dinamike , i padituri këstin e parë në shumë prej ... euro, do filloi ta paguajë me datën 01.03.2013 , e kështu radhazi për ... muaj , deri në pagesën e këstit të fundit, me datën 01.02.2014.I padituri , dinamikës së pagesave iu përmbajtë vetëm 2 muajtë e parë , për të cilën periodë , në emër të primit të sigurimit , pagoi shumën prej ... euro. Me pagesat në vijim, për 10 muajtë e mbetur, i paditurit jo vetëm se ra në vonesë të pagesave, por i njëjti , deri me ditën e skadimit të sigurimit, në terësi dështoj të ia paguajë këstet e mbetura, ashtu që për pjesën e mbetur të primit të papaguar i mbeti borgj paditësit , mjete në shumë prej ... euro.

I autorizuari i paditësës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se bazuar ne padinë e parashtruar në këtë gjykatë për pagesën e borgjit mjeteve shuma ... euro , provave të prezantuara ne seancë kryesore , paditësja mendon se gjykatës i ka dëshmuar se padia respektivisht kërkesëpafia është e bazuar andaj i propozoj gjykatës te marrë aktgjykim me të cilin të paditurin P. K. ta detyroje që i njëjti ta paguajë borgjin të cilin e ka ndaj paditësit, shuma ... euro shtese kamatë ligjore në këtë shumë me normë vjetore siç parasheh LMD. Shpenzimet e procedurës i kërkoj dhe atë në emër të pagesë së taksës për parashtrimin e padisë dhe për nxjerrjen e aktgjykimit nga ana e gjykatës.

Në seancën e datës 22.11.2016 pasi që i njëjti ka deklaruar se deri në ditën e sotme nuk kam marrë aktvendimin mbi dhënien e pergjegjes në padi së bashku me padinë dhe provat tjera të dorëzuara nga pala paditëse por i njëjti deri në seancën e fundit gjyqësore nuk ka dhënë përgjigje

në padi e as që është paraqitur në seancën e fundit të datës 24.01.2017 andaj gjykata seancën e mbajti në mungesë të paditurit pasi që i njehti parapraksiht është njoftuar gojarisht në seancën e datës 22.11.2016 e konform dispozitave të nenit 424 par 4 të LPK-së.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë nxjerrjen e këtyre provave : janë shikuar polisa sigurimi i shëndetit dhe aksidentet personale datë 28.02.2013 ,konfirmimi i sigurimit date 02.09.2014,faturë pagesa e datës 28.02.2013 , kartela e P.K. nr.... si dhe lënda : ... datë 28.01.2014.

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha së bashku e në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga polisa e sigurimit të shëndetit dhe aksidentet personale të datës 28.02.2013 është vërtetuar se paditësi dhe i padituri kanë kontraktuar policën e sigurimit të shëndetit dhe aksidentet personale me mbulesë sigurorese 1 vjeçare nga data 01.03.2013 deri me 28.02.2014 me të cilën policë i padituri ka qenë i obliguar që në emër të primit të sigurimit ti paguajë mjetet në shumë prej ...euro .

Sipas paditëses i padituri ka paguar vetëm 2 muajtë e parë të kësteve mujore veç e veç nga 88,81 euro gjegjësisht në shumë të përgjithshme prej 167,62 euro e që nuk e konteston edhe i padituri.

Nga provat e nxjerra përkatësisht polica e sigurimit të datës 28.02.2013 si dhe deklarimi i të autorizuarit të paditësit rrjedhë se i padituri paditëses nga kjo kontratë përkatësisht borgji i përgjithshëm fillestar prej .... euro është zbritur në ... euro pasi që i padituri ka paguar 2 këste nga 88,81 euro dhe nga kjo rrjedh se i padituri i ka mbetur paditëses borgj në shumë prej .... euro .

Sipas dispozitave të nenit 106 të LMD-së në kontratat e dyanshme ku njera palë nuk e përmbushë detyrimin e saj pala tjetër mundë ne qofte se nuk është caktuar diçka tjetër të kerkoje përmbushjen e detyrimit e që në rastin konkret e drejta e paditësit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit është e ligjshme dhe e drejtë sepse i padituri me asnjë provë nuk ka vërtetuar se e ka përmbushur kontratën ( policën) e lidhur me datën 28.02.2013.

Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e bazon në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së dhe përfshin shumën prej 15 euro e që ka të bëjë me taksën gjyqësore për ngritjen e padisë.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË me dt. 25.01.2017.

G j y q t a r i

MSc.Fatmir Baloku

#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit, ankesa I drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.